

## FJALA E GVERNATORIT

Ekonomia shqiptare ka pasur një ecuri pozitive në gjashtëmuajorin e parë të vitit.

Sipas të dhënave të disponuara, vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit me 3.4% në tremujorin e parë, i nxitur nga rritja e konsumit të familjeve, e investimeve publike dhe private, si dhe e eksportit të mallrave e shërbimeve. Kjo ecuri u pasqyrua në rritjen e mëtejshme të punësimit në sektorin privat jobujqësor, në rritjen e pagave, si dhe në rënien e normës së papunësisë në nivele minimale historike. Të dhënat e tërthorta të disponuara sugjerojnë trende të ngjashme zhvillimi edhe në tremujorin e dytë.

Inflacioni i çmimeve të konsumit vijoi të mbetet në nivele të ulëta. Ai shënoi një normë mesatare prej 2.3% në tremujorin e dytë, duke shënuar një rritje të lehtë nga vlerat e tremujorit të parë, por duke vijuar të mbetet poshtë objektivit prej 3% të Bankës së Shqipërisë.

Rritja e punësimit dhe e pagave, si dhe nivelet e ulëta të inflacionit, kanë mundësuar rritjen e të ardhurave për familjet shqiptare.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka vijuar të mbetet e fokusuar në krijimin e një ambienti financiar të përshtatshëm për përmbushjen e objektivit tonë të inflacionit. Ecuria e qëndrueshme ekonomike dhe nivelet e ulëta të inflacionit diktuan një lehtësim të mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare në fillim të muajit korrik. Ky lehtësim mori formën e reduktimit të normës bazë të interesit, nga niveli 2.75% në nivelin 2.5%. Ai ka filluar të transmetohet në tregjet financiare dhe pritet të sjellë një reduktim të përgjithshëm të normave të interesit të kredive dhe depozitave në Lekë, duke nxitur më tej kreditimin, konsumin dhe investimet.

Kushtet e përgjithshme monetare vijojnë të mbeten në nivele të përshtatshme për kontrollin e inflacionit dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Në veçanti, normat e ulëta të interesit, pritjet pozitive për ecurinë e ekonomisë, bilancet e shëndosha të sistemit bankar dhe rritja e konkurrencës në të, kanë sjellë një rritje të shpejtë dhe me bazë të gjerë të kreditimit. Nga ana tjetër, ecuria e kursit të këmbimit ka qenë më e qëndrueshme gjatë vitit 2025, e diktuar si nga një ecuri e balancuar e kërkesës dhe ofertës për valutë, ashtu edhe nga rritja e prezencës së Bankës së Shqipërisë në tregjet e brendshme valutore.

Bazuar në trendet aktuale, parashikimet tona për të ardhmen mbeten pozitive. Ekonomia shqiptare pritet të rritet me ritme të qëndrueshme, rreth nivelit 3.5 – 4%, gjatë tre viteve në vijim. Inflacioni pritet t'i afrohet gradualisht objektivit tonë



prej 3% brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm, ndërkohë që ekuilibrat e brendshëm dhe të jashtëm të vendit, duke përfshirë edhe shëndetin e sistemit bankar, pritet të përmirësohen më tej.

Megjithatë, perspektiva e zhvillimeve ekonomike rrethohet nga pasiguri të shtuara, të cilat burojnë kryesisht nga tensionet gjeopolitike dhe tensionet e rritura ekonomike e tregtare në ambientin e huaj. Materializimi i këtyre rreziqeve do të kishte pasoja potencialisht negative mbi ecurinë ekonomike dhe nivelin e inflacionit në vend.

Në këto rrethana, në mbledhjen e datës 6 gusht 2025, Banka e Shqipërisë mbajti të pandryshuar qëndrimin e politikës monetare dhe nivelin e normës bazë të interesit. Ky vendim i shërben ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit në afatin e mesëm.

